

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 5 (pesë) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Asistent Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit

- Në programet e studimit të Ciklit të parë, *Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Informatike* (FTI-UPT), si dhe *Bachelor në Inxhinieri Mekatronike* (FIE-UPT):
- *Elektronika e Sistemeve të Programueshme* (Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Teoria e Sinjaleve* (Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore).

Kandidati I duhet të dorëzojnë dokumentacionin (origjinal ose kopje të noterizuara), në plotësim të dosjes përkatëse të kandidatit, si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Elektronike ose Inxhinierisë së Telekomunikacionit (Kriter Hyrës);
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve (për studimet 5-vjeçare), (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 , në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër (Kriter Hyrës);
3. Dëshminë/Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik C (Kriter Preferencial);
4. Artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN, Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë së Elektronikës dhe/ose të Telekomunikacionit, si tregues për fushën kërkimore-shkencore të kandidatit (Kriter Preferencial);
5. Trajnime të ndryshme në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit. (Kriter Preferencial);
6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në FTI (UPT), të dëshmuar me referenca, në fushat e teknologjisë së informacionit, shkenca aplikative, si dhe fusha të ngjashme (Kriter Hyrës);
7. Dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në DET (FTI-UPT), nga staf akademik i DET (FTI-UPT), ose nga departamenti përkatës

(Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar (Kriter Hyrës);

8. Kandidati preferohet të ndjekë ciklin e tretë të studimeve të Doktoratës në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit

Në programet e studimit të Ciklit të parë, *Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, Bachelor në Inxhinieri Informatike, Bachelor në Inxhinieri Elektrike (Automatizim, Energjetike, Mekatronike)*, si dhe në programin e studimit të Ciklit të dytë, *Master Shkencor në Inxhinieri Elektronike*:

- *Elementet dhe Teknologjitë Elektronike* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Elektronike Fuqie* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Fizika e Materialeve Elektronike* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore).

Kandidati 2 duhet të dorëzojnë dokumentacionin (origjinal ose kopje të noterizuara), në plotësim të dosjes përkatëse të kandidatit, si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, ose në Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushat e Teknologjisë së Informacionit, si dhe në fushat e shkencave aplikative, matematike, fizike, ose fusha të ngjashme. (Kriter Hyrës);
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve (për studimet 5-vjeçare), (Bachelor + Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 , në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër (Kriter Hyrës);
3. Dëshminë/Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik C (Kriter Preferencial);
4. Artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings. me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushat e teknologjisë së informacionit, shkencat aplikative dhe fusha të ngjashme si (Kriter Preferencial);
5. Në kuadrin e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit që mbulon DET, por edhe të diplomave të përbashkëta që DET ka në ciklin e studimeve master me UniGe (Itali) dhe UTC (France), por edhe të programit të përbashkët të studimit në ciklin bachelor me UTC, DET ka

në vizionin e tij dhënien përparësi të kandidatëve, student të ekselencës, që kanë studiuar në Universitete Perëndimore (vende anëtare të BE-së, kryesisht Itali, Hollandë dhe Francë) (Kriter Preferencial);

6. DET po menaxhon një sërë projektsh të shkollës doktorale me orientim arritjet e fundit të shkencës dhe teknologjisë, dhe në këtë këndvështrim, DET është i interesuar për të pranuar kandidat për staf akademik që mbulojnë fushat e ekspertizës së DET por edhe të udhëheqin student doktorat, përfshirë fushat e teknologji të informacionit por edhe fusha të reja të kerkimit shkencor të tilla si “Përdorimi i transistorëve me efekt fushe me nanotuba karboni si element sensor në fenomenet e fluideve në shkallë nano” IoT, AI, Machine Learning, Data Base, Big Data, Cyber Security, etj. (Kriter Preferencial);
7. Të ketë trajnime të ndryshme në fushat e teknologjisë së informacioni, shkencat aplikative si dhe fusha të ngjashme (Kriter Preferencial);
8. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie të dëshmuar me referenca, në fushat e teknologjisë së informacionit, shkenca aplikative, si dhe fusha të ngjashme (Kriter Hyrës);
9. Dy rekomandime, me datë jo më hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në DET (FTI-UPT), nga staf akademik i FTI (UPT), ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar (Kriter Hyrës);
10. Kandidati të jetë i kategorisë “Profesor” (Kriter Hyrës).

C. 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit

Në programet e studimit të Ciklit të dytë, *Master Shkencor në Inxhinieri Telekomunikacioni, si dhe Master Profesional në Teknologji Informacioni si dhe në Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni*.

- *Teoria e Informacionit dhe Kodet* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Siguria në Rrjeta 1* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Siguria në Rrjetat e Kompjuterave* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Machine Learning* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);
- *Procese dhe Sisteme* (Leksione, Ushtrime/Seminare, Detyra/Projekte Kursi, Laboratore);

Kandidati 3 duhet të dorëzojnë dokumentacionin (origjinal ose kopje të noterizuara), në plotësim të dosjes përkatëse të kandidatit, si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, ose në Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e

- studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushat e Teknologjisë së Informacionit, si dhe në fushat e shkencave aplikative, matematike, fizike, ose fusha të ngjashme. (Kriter Hyrës);
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve (për studimet 5-vjeçare), (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 , në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër (Kriter Hyrës);
 3. Dëshminë/Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze ne nivel akademik C (Kriter Preferencial);
 4. Artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proccedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushat e teknologjisë së informacionit, shkencat aplikative dhe fusha të ngjashme si (Kriter Preferencial);
 5. Në kuadrin e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit që mbulon DET, por edhe të diplomave të përbashkëta që DET ka në ciklin e studimeve master me UniGe (Itali) dhe UTC (Francë), por edhe të programit të përbashkët të studimit në ciklin bachelor me UTC, DET ka në vizionin e tij dhënien përparësi të kandidatëve, student të ekselencës, që kanë studiuar në Universitete Perëndimore (vende anëtare të BE-së, kryesisht Itali, Hollandë dhe Francë) (Kriter Preferencial);
 6. DET po menaxhon një sërë projektsh të shkollës doktrale me orientim arritjet e fundit të shkencës dhe teknologjisë, dhe në këtë këndvështrim, DET është i interesuar për të pranuar kandidat për staf akademik që mbulojnë fushat e ekspertizës së DET por edhe të udhëheqin student doktoral, përfshirë fushat e teknologjisë së informacionit por edhe fusha të reja të kërkimit shkencor të tilla si IoT, AI, Machine Learning, Data Base, Big Data, Cyber Security, etj. (Kriter Preferencial);
 7. Të ketë trajnime të ndryshme në fushat e teknologjisë së informacioni, shkencat aplikative si dhe fusha të ngjashme (Kriter Preferencial);
 8. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në FTI (UPT), të dëshmuar me referenca, në fushat e teknologjisë së informacionit, shkenca aplikative, si dhe fusha të ngjashme (Kriter Hyrës);
 9. Dy rekomandime, me datë jo më hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në DET (FTI), nga staf akademik i DET (FTI-UPT), ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar (Kriter Hyrës);
 10. Kandidati të jete i kategorisë “Profesor” (Kriter Hyrës).

D. 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Lektor” në Departamentin e Bazave të Informatikës për lëndët “Informatika” dhe “Bazat e Informatikës”

Kriteret që duhet të plotësojë aplikanti si më poshtë:

1. Diplomë 3+2 ose 5 vjeçare në Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës ose diploma të ngjashme nga UPT dhe universitete të tjera;
2. Sipas statutit të UPT-së nota mesatare e studimeve Bachelor+Master i Shkencave ≥ 8 (kriter Hyrës);
3. Kandidati të jetë i kategorisë “Profesor”;
4. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në këtë vend vakant;
5. Preferohet të ketë eksperiencë pune të mëparshme në mësimdhënie në universitet (me kohë të plotë ose të pjesshme);
6. Preferohet të ketë artikuj të botuar në revista shkencore me bord editorial dhe kod ISSN dhe/ose referime shkencore në konferenca shkencore të botuara në proceedings me kod ISBN.

E. 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Asistent Lektor” në Departamentin e Bazave të Informatikës për lëndët “Informatika” dhe “Bazat e Informatikës”

Kriteret që duhet të plotësojë aplikanti si më poshtë:

1. Diplomë 3+2 ose 5 vjeçare në Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës ose diploma të ngjashme nga UPT dhe universitete të tjera;
2. Sipas statutit të UPT-së nota mesatare e studimeve Bachelor+Master i Shkencave ≥ 8 (kriter Hyrës);
3. Preferohet të jetë student doktorature në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit;
4. Dëshmi/Certifikate e mbrojtjes së gjuhës së huaj përmes testeve ndërkombëtare, preferohet niveli C1 dhe gjuha angleze;
5. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në këtë vend vakant;

6. Preferohet të ketë eksperiencë pune të mëparshme në mësimdhënie në universitet (me kohë të plotë ose të pjesshme);
7. Preferohet të ketë artikuj të botuar në revista shkencore me bord editorial dhe kod ISSN dhe/ose referime shkencore në konferenca shkencore të botuara në proceedings me kod ISBN.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **19.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.